



VENDIM

Nr. 46 Datë 14 .06.2010

**MBI KERKESEN E OSSH SH.A, LIDHUR ME NIVELIN E
HUMBJEVE TE ENERGJISE ELEKTRIKE PER VITIN 2008**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2, germa f, 9, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, pikës 4,5 dhe 6 të Deklaratës Rregulatore, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionereve nr.12 date 03.03.2009, nenit 23 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionereve të ERE-s, nr.21 date 18.03.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 14.06.2010, mbasi analizoi kërkesën e OSSH sh.a të dates 27.04.2010, dhe rezultatet e monitorimit të kryer nga ERE në zonat e shpërndarjes së OSSH sh.a, dhe relacionin e Drejtorive Teknike të ERE-s që ka kryer këtë monitorim ,

Konstatohet se :

- Auditi i Humbjeve i kryer nga ADL, nuk arriti të verifikonte dhe të percaktonte nivelin e humbjeve totale për vitin 2008 në sistemin e shpërndarjes për shkak të kohës së shkurtër për verifikime dhe pamjaftueshmërinë e dokumentacionit dhe të të dhënave.
- Bordi i Komisionereve për qëllim të llogaritjes së tarifave të energjisë elektrike për vitin 2010 pranoi nivelin e deklaruar të humbjeve për vitin 2008 në masën e deklaruar nga OSSH (përpara privatizimit) në nivelin 32.74%, duke e lënë të hapur të drejtën për tu shprehur në kuadër të të dhënave që do të rezultojnë e verifikoheshin në vijim.

- Nga monitorimi i kryer nga ERE lidhur me humbjet ne shperndarje ka elemente te tille si vetkonsumi i OSSH sha, mbifaturimeve te ndryshme, efektet e kufizimeve te furnizimit me energji elektrike te konsumatoreve, te cilat ndikojne ne nivelin e humbjeve ne shperndarje dhe nuk jane marre ne konsiderate ne shifren e supozuar sipas Deklartes regullatore (pika 4,5).
- Deklarata Rregullatore pika 4.5 paragrafi 7, percakton se Niveli i Humbjeve Aktuale per vitin 2009 do te pranohet i barabarte me nivelin aktual te vitit 2008 dhe do te jete plotesisht i tranferueshem ne tarifat e DSO (OSSH) ne perputhje me Mekanizmin e Kompensimit te pershkruar ne piken 6 dhe do te sherbeje si nivel fillestar per programin e uljes se humbjeve ne perpiudhat e percaktuara.

Per gjithë sa me siper Bordi i Komisionereve te ERE-s

Vendosi :

1. Niveli i humbjeve te pranuar per OSSH per vitin 2008, per efekt te vendosjes se objektivave te humbjes per tre periudhat rregullatore (2010 -2014) sipas Deklartes Rregullatore dhe te llogaritjes se tarifes se shperndarjes eshte 33.92 %.
2. Efektet financiare te axhustimit te te ardhurave te kerkuara sipas pikes 1 te ketij vendimi do te reflektohen ne tarifat per shoqerine OSSH sha, duke perdorur mekanizimin e kompensimit sic percaktohet ne Deklaraten Rregullatore.
3. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë OSSH sh.a për këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S

BUJAR NEPRAVISHTA

Adresa:Rruga “Gjergj Fishta”10
Tirane
69 590
E-mail erealb@ere.gov.al

Tel/Fax +355 42 22 963
Tel +355 42

www.ere.gov.al